**Ministri i Kulturës, Asaf Ademi, mbrëmë në Shtëpinë e ARM mori pjesë në solemnitetin, me rastin e shënimin të jubileut të pestë të studion së vallëzimit “Dancers United MK”, në kuadër të të cilit u mbajt koncert humanitar inkluziv i vallëzimit, ku performuan persona me sindromën Dawn dhe persona me pengesa në zhvillim ...**



Në fjalimin e tij të shkurtër, para të pranishmëve, ministri Ademi theksoi se pranimi i tjetrit dhe respektimi i diversiteteve është detyrim dhe kujdes i shoqërisë.





